

**STATUTI**  
**I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“OLIA - AL” SH.P.K.**

Sot, më datë 06.12.2021, **Erjol Menkshi**, bazuar në vullnetin e tij të lirë themeloi shoqërinë “**OLIA - AL**” **SH.P.K.**, në përputhje me Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe vendosi të hartojë këtë statut për funksionimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**OLIA - AL**” **SH.P.K.**

**KREU I**

**THEMELIMI, EMRI, KOHËZGJATJA, SELIA**

**Neni 1**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

Sot, më 06.12.2021 unë, themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “**OLIA - AL**” **SH.P.K.**

Themeluesi i shoqërisë është:

**Z.Erjol Menkshi**, i biri i Perparimit, i datëlindjes 05.08.1995, mbajtës i dokumentit të identitetit me numër 033376547 dhe Numër Personal J50805069Q, lindur në Homezh, Pogradec dhe banues në Tiranë, Njësia Administrative Nr.5, Rr.“ Bulevardi Bajram Curri”, Zona Kadastrale Nr.8260, Pasuria me Numër 1/314+1-16, Ndërtesa Nr.22, Shkalla 5, Apartamenti 12, Kodi postar 1022.

**Neni 2**

**Selia**

Selia juridike e Shoqërisë, ndodhet në Tiranë, Njësia Administrative Nr.5, Rr.“ Bulevardi Bajram Curri”, Zona Kadastrale Nr.8260, Pasuria me Numër 1/314+1-16, Ndërtesa Nr.22, Shkalla 5, Apartamenti 12, Kodi postar 1022.

Shoqëria me miratimin e organeve kompetente, mund të krijojë qendra sekondare, filiale, zyra përfaqësimi e agjensi në qytete të tjera të Shqipërisë ose jashtë vendit.





### **Neni 3 Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papercaktuar.

### **Neni 4 Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Invesitor në ndërtim. Veprimtari në fushën e ndërtimeve civile, industriale, banesa, hotele, objekte kulti, rrugë, infrastrukturë, etj. Punime të përgjithshme në ndërtim, rikonstruksione dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, punime nëntokësore; ura e vepra arti, diga dhe tunele hidroteknike, ujësjellësa, gazsjellësa, vajsjellësa, vepra kullimi e vaditje, punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikime, punime të inxhinierise së mjedisit, rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale, ndërtime për nënstationet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të mesëm dhe të lartë dhe shpërndarje të energjisë, ndërtim i impianteve për prodhimin e energjise elektrike.

Import - Eksport, tregtim me shumicë e pakicë të mallrave të ndryshëm ushqimorë, industrialë, të veshjeve, këpucëve, konfeksioneve, produkteve të kozmetikës, materialeve të ndërtimit, sportive, pijeve alkolike, bimëve mjekësore, duhanit, cigareve, karburanteve, vajrave, automjete e pjesëve këmbimi për automjete, i paisjeve dhe aparaturave që shërbejnë për mbikqyrjen dhe ruajtjen fizike të pronës dhe individit. Import – Eksport, tregti të lëndëve të para, linjave teknologjike për industrinë ushqimore, të përpunimit të materilave drusore dhe hidrokarbureve, të përpunimit të lëkurës dhe veshmbathjeve, të aparaturave në fushën e shëndetit dhe trajtimit të medikamenteve mjekësore, etj.

Transport mallrash dhe udhëtaresh, brenda dhe jashtë vendit.

Aktivitet në fushën e turizmit, hapje agjensi udhëtimit dhe marketing, veprimtari në fushën e hotelerisë, bar kafe, restorante, supermarkete, etj.

Shërbime në fushën publike, shërbime të ndryshme komunale publike, riparim objektesh publike dhe shërbime menaxhimi të tjera në fushën e shërbimeve publike.

Shoqëria mund të kryejë edhe aktivitete të tjera, të marrë pjesë në sipërmarrje të tjera brenda dhe jashtë vendit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **KREU II**

### **KAPITALI**

#### **Neni 5 Kapitali themeltar**

Kapitali fillestar i shoqërisë është 2 000 000 (dymilionë) lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre, si më poshtë:

Ortaku themelues **Z. Erjol Menkshi**, zotërues i 1(një) kuote të kapitalit, me vlerë 2 000 000 (dymilionë) lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë.





**Neni 6**  
**Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Nëe asnjë rast, shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet nga Asambleja e Ortakëve në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i kapitalit i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

**Neni 7**  
**Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve përderisa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**KREU III**  
**ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE**

**Neni 8**  
**Organi Vendimarrës**

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimin e statutit
- c) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të këtij neni
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursionit të veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursionit të veprimtarisë;





- ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamble të përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamble të përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamble se përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### **Neni 9**

#### **Mënyra e thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme e Ortakëve**

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret nepermjet një njoftimi me shkresë ose nepermjet postës elektronike. Njoftimi duhet me shkresë ose mesazh elektronik, duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes, rendin e ditës dhe t'u dërgohet të gjithë ortakëve jo më vonë se para 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblese.

Kur, asambleja e përgjithshme e ortakëve nuk është thirrur sipas kësaj mënyre, ajo mund të marrë njoftime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### **Neni 10**

#### **Kuorumi**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të Ligjit "Për tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysma e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të Nenit 88 të ligjit sipërmendur.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet perseri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **Neni 11**

#### **Marrja e Vendimeve**

Asambleja e përgjithshme e Ortakëve, vendos me tre të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.





Asambleja e pergjithshme e ortakeve vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtje te tjera, si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin dhe shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shperblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB-se per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

### Neni 12

#### Përfshirja nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij;
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria;
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

Kur ortaku perfaqesohet nga nj i perfaqesuar i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njetin konflikt interesi, ashtu sic eshte dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

### Neni 13


#### Administrimi

Administrator i shoqerise emerohet:


**Z.Erjol Menkshi**, i biri i Perparimit, i datëlindjes 05.08.1995, mbajtës i dokumentit të identitetit me numër 033376547 dhe Numër Personal J50805069Q, lindur në Homezh, Pogradec dhe banues në Tiranë, Njësia Administrative Nr.5, Rr.“ Bulevardi Bajram Curri”, Zona Kadastrale Nr.8260, Pasuria me Numër 1/314+1-16, Ndërtesa Nr.22, Shkalla 5, Apartamenti 12, Kodi postar 1022.

Z.Erjol Menkshi, emërohet në këtë detyrë për një periudhë 5 vjecare, me të drejtë ripërtëritje.

Emer Mbiemer

  
\_\_\_\_\_

Nënshkrimi

  
\_\_\_\_\_

Administratori i shoqerisë mund të emërohet edhe një person i tretë jashtë ortakerisë.

### Neni 14

#### Kompetencat e Administratorit





Administratori ka të drejtë e detyrohet:

- a) te kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e pergjithshme ;
- b) te përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) te kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) te përgatisin dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së pergjithshme për miratim;
- d) te krijoje një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- e) te kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- f) te raportojë përpara asamblesë së pergjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- g) te kryjete detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Nese Asambleja e Pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje administratorin e shoqerise ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Padite qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

## **Neni 15** **Përgjegjësitë e Administratorit**

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e pergjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te percaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të





përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

#### **KREU IV VITI FINANCIAR- EKSPERTËT**

##### **Neni 16 Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar, fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, miraton Llogarite vjetore të paraqitura nga Administratori, vendos për krijimin e fondit rezerve, fondeve për investime, si dhe destinime të tjera të fitimit ose humbjes së vitit ushtrimor.

##### **Neni 17 Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë. i ngarkuar nga ana e





ortakeve

Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor, si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtes vendimore që ka.

## KREU V

### PRISHJA – RIORGANIZMI I SHOQËRISË

#### Neni 18 Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket..

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### Neni 19

#### Riorganizimi i shoqerisë: Baskimi- Ndarja

Shoqëria mund te ndahet , bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se pergjithshme te Asamblese se Ortakeve , ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2012 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“.

#### Neni 20

#### Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në ketëe statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.



**Neni 21**  
**Mosmarrëveshjet**

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

**ORTAKU**

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“OLIA - AL” SH.P.K.**

**Erjol MENKSHI**

Erjol Menkshi  
